# ГЛАСИЛО
# GAZETË

Декември / Dhjetor 2023





## ЗЕЛС

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

## BNJVL

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Почитувани,

Активностите на ЗЕЛС не стивнуваа и во последниот месец од годината. На почетокот на декември, Генералното собрание на ЗЕЛС ја одржа петтата седница на која делегатите ги разгледаа и ги усвоија Акцискиот план и Буџетот на ЗЕЛС за 2024 година, а претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски, ги информира за активностите на Управниот одбор на ЗЕЛС и за идните планови на Заедницата. Тој го нагласи и усвојувањето на Систематизираните ставови на ЗЕЛС за 2024 година, значаен документ во којшто се утврдени сите цели за лобирање и каде што посебно внимание е посветено на заложбите за обезбедување на електронски систем за данокот на имот и воведување на комунална полиција.

На седницата на Надзорниот одбор на ЗЕЛС се дискутираше за приходите на ЗЕЛС за 2024 година, коишто во најголем процент се обезбедуваат од членарината на единиците на локалната самоуправа. Беше нагласено дека ЗЕЛС максимално рационално ги троши сите средства за потребите на општините, овозможувајќи им заштеда, што особено се забележува во користењето на електронските системи. Надзорниот одбор упати апел до сите општини за редовно плаќање на членарината, а оние што имаат долг да го отплатат што поскоро, бидејќи ќе се пристапи кон воведување на нови мерки за подобрување на наплатата на членарината.

Во текот на овој месец беа одржани и повеќе работилници и обуки за јакнење на капацитетите на општинската администрација. Овластените просветни општински инспектори изнесоа низа предизвици со кои се соочуваат при спроведувањето на своите надлежности и разменија искуства за нивно решавање, а беше презентиран и новиот предлог-концепт за постсредно образование. Во просториите на ЗЕЛС тренинг центарот, обемна дискусија по Предлог-законот за градење водеа и општинските градежни инспектори. ЗЕЛС продолжи и со обуките што ги реализира во општините кои доброволно изразија интерес на повикот на ЗЕЛС и се пријавија за следење на еднодневната обука за јакнење на капацитетите на членовите на Советот за социјална заштита на општината. Во овој месец, вакви обуки беа реализирани во општините Карпош и Неготино.

Крајот на годината го одбележа и потпишувањето на договори од страна на 44 општини за реализација на шеесет и шест проекти, со вкупна вредност од 32,5 милиони евра. Проектите се однесуваат за реконструкција на улици и локални патишта, изградба и реконструкција на училишта и градинки, на здравствени установи, спортски сали, домови за култура, мостови, пречистителни станици и други проекти, кои се обезбедени од буџетот на шест министерства на Владата на РСМ. За сето ова може да прочитате во овој број на Гласило на ЗЕЛС.

Со почит,

Душица Перишиќ,
извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Aktivitetet e BNJVL-së nuk u ndalën as në muajin e fundit të vitit. Në fillim të dhjetorit, Kuvendi Gjeneral i BNJVL-së mbajti seancën e pestë, në të cilën delegatët shqyrtuan dhe miratuan Planin aksionar dhe buxhetin e BNJVL-së për vitin 2024, ndërsa kryetari i BNJVL-së, Orce Gjorgjievski informoi për aktivitetet e Bordit drejtues të BNJVL-së dhe planet e ardhshme të Bashkësisë. Ai theksoi edhe miratimin e QËNDRIMEVE TË SISTEMATIZUARA TË BNJVL-së për vitin 2024, dokument i rëndësishëm, ku përcaktohen të gjitha qëllimet e lobimit, ku vëmendje e veçantë u kushtohet përpjekjeve për sigurimin e sistemit elektronik për tatimin në pronë dhe aplikimin e policisë komunale.

Në seancën e Bordit mbikëqyrës të BNJVL-së u diskutua për të hyrat e BNJVL-së për vitin 2024, të cilat më së shumti sigurohen nga anëtarësia e njësive të vetëqeverisjes lokale. U theksua se BNJVL-ja i shpenzon të gjitha mjetet për nevojat e komunave në mënyrë sa më racionale, duke u mundësuar komunave të kursejnë, gjë që vërehet veçanërisht në përdorimin e sistemeve elektronike. Bordi mbikëqyrës u bëri një apel të gjitha komunave për pagesë të rregullt të anëtarësisë, ndërsa ato që kanë borxh ta shlyejnë atë sa më shpejt, sepse do t'i qaset aplikimit të masave të reja për përmirësimin e arkëtimit të mjeteve të anëtarësisë.

Gjatë këtij muaji u mbajtën edhe disa punëtori dhe trajnime për fuqizimin e kapaciteteve të administratës komunale. Inspektorët e autorizuar arsimorë komunalë prezantuan një sërë sfidash me të cilat ballafaqohen në realizimin e kompetencave të tyre dhe shkëmbyen përvoja për zgjidhjen e tyre, ndërsa u prezantua edhe propozim-koncepti i ri për arsimin pas arsimit të mesëm. Edhe inspektorët komunalë të ndërtimit kanë pasur një diskutim të gjerë për Projektligjin për ndërtim në hapësirat e Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së. BNJVL-ja vazhdoi edhe me trajnimet që i realizon në komunat të cilat vullnetarisht kanë shprehur interesim për thirrjen e BNJVL-së dhe u paraqitën për të ndjekur trajnimin njëditor për përforcimin e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit për mbrojtje sociale të komunës. Këtë muaj, trajnime të këtilla janë realizuar në komunën e Karposhit dhe të Negotinës.

Fundin e vitit e shënoi edhe nënshkrimi i kontratave nga ana e 44 komunave për realizimin e gjashtëdhjetë e gjashtë projekteve, me vlerë totale prej 32.5 milionë Eurosh. Projektet kanë të bëjnë me rindërtimin e rrugëve dhe rrugëve lokale, ndërtimin dhe rindërtimin e shkollave dhe kopshteve të fëmijëve, objekteve shëndetësore, sallave sportive, qendrave të kulturës, urave, impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe projekte të tjera, ndërsa sigurohen nga buxhetet e gjashtë ministrive të Qeverisë e RMV-së. Për të gjitha këto mund të lexoni në këtë numër të Gazetës së BNJVL-së.

Me respekt,

Dushica Perishiq,
drejtor ekzekutiv i BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија
**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Арта Абази
**Лекторирал:** Валентина Великова
**Дизајн и подготовка и печатење:** Европа 92

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „ Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema - Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska - Dinkovska
**Përkthim:** Arta Abazi
**Lektoron:** Valentina Velikova
**Dizajnim dhe përgatitje shtyp:** Evropa 92

# „ГРАЃАНИТЕ ВО ФОКУС: КРЕИРАЊЕ ИДНИНА СО ПОКВАЛИТЕТНИ ЛОКАЛНИ УСЛУГИ“ – ТЕМА НА ГОДИШНАТА КОНФЕРЕНЦИЈА ЗА ДЕЦЕНТРАЛИЗАЦИЈА И ЛОКАЛНО УПРАВУВАЊЕ

„Во нашата земја не се почитува Европската повелба за локална самоуправа каде стриктно е нагласено дека за секоја префрлена надлежност на локално ниво, централната власт треба да обезбеди и соодветни средства за нејзино спроведување. И наместо да се јакне децентрализацијата, која со себе носи и зголемена демократија и учество на граѓаните во креирање на сопствените потреби, ние имаме уназадување, игнорантски однос на централната власт кон општините, недоверба и застој во спроведувањето на потребните реформи на локално ниво.“ Ова го истакна претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски, на почетокот од своето обраќање на годишната конференција за децентрализација и локално управување што се одржа на 6 и 7 декември 2023 година, на тема „Граѓаните во фокус: Креирање иднина со поквалитетни локални услуги“, организирана од Програмата за развој на Обединетите нации во нашата земја (УНДП) и Министерството за локална самоуправа (МЛС)

Ѓорѓиевски нагласи дека општините се подготвени да им понудат поквалитетни услуги и европски стандарди на своите граѓани, но се принудени да одвојуваат дополнително од сопствените приходи најмалку 50 % од износот што го добиваат во блок дотациите, и тоа особено кај противпожарната заштита, образованието, градинките и друго. Сепак, според Ѓорѓиевски, и во вакви услови, но со голема заложба и ентузијазам од општините, има континуиран напредок во квалитетот на услугите и подобрување на условите за живот на граѓаните. Тој потенцираше дека е особено важно да се обезбеди финансиска поддршка за реализирање на големи инфраструктурни проекти во водоснабдувањето, локалните патишта, канализациските мрежи, стандардизирани депонии и слично.

„ЗЕЛС во своите Систематизирани ставови за 2024 година се залага за повторно отпочнување на процесот на реформи во локалната власт и во организациската

# “QYTETARËT NË FOKUS: KRIJIMI I ARDHMËRISË ME SHËRBIME MË CILËSORE LOKALE” – TEMË E KONFERENCËS VJETORE PËR DECENTRALIZIM DHE MENAXHIM LOKAL

“Në vendin tonë nuk respektohet Karta Evropiane për vetëqeverisje lokale ku në mënyrë të rreptë theksohet se për çdo kompetencë të transferuar në nivel lokal, pushteti qendror duhet të sigurojë edhe mjete adekuate për zbatimin e saj. Ndërsa në vend që të përforcohet decentralizimi, që me vete mban edhe demokraci të zhvilluar dhe pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin e nevojave personale, ne kemi ngecje, sjellje injoruese të pushtetit qendror ndaj komunave, mosbesim në zbatimin e reformave të nevojshme në nivel lokal”. Këtë e theksoi kryetari i BNJVL-së Orce Gjorgjievski, në fillim të fjalimit të tij në konferencën vjetore për decentralizim dhe menaxhim lokal që u mbajt më 6 dhe 7 dhjetor, 2023, me temë “Qytetarët në fokus: Krijimi i të ardhmes me shërbime më cilësore lokale”, organizimi i Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale (MVL).

Gjorgjievski theksoi se komunat janë të gatshme të ofrojnë shërbime më cilësore dhe standarde evropiane për qytetarët e tyre, por janë të detyruara të ndajnë më tepër mjete nga të ardhurat e tyre për së paku 50% të shumës që marrin në bllok dotacione, veçanërisht për mbrojtjen nga zjarri, arsimi, kopshtet dhe të tjera. Megjithatë, sipas Gjorgjievskit, edhe në këto kushte, por me përkushtim dhe entuziazëm të madh nga komunat, ka progres të vazhdueshëm në cilësinë e shërbimeve dhe përmirësimin e kushteve të jetës së qytetarëve. Ai theksoi se është veçanërisht e rëndësishme që të ofrohet mbështetje financiare për realizimin e projekteve të mëdha infrastrukturore në ujësjellës, rrugë lokale, rrjete kanalizimesh, deponi të standardizuara etj.

“BNJVL, në Qëndrimet e sistematizuara për vitin 2024, ndër të tjera avokon për rifillimin e procesit të reformave në pushtetin lokal; reformat për të siguruar stabilitet financiar; reformat në strukturën organizative të



поставеност на општината и на советите; за обезбедување на финансиска стабилност и префрлање на нови надлежности на општините, само доколку се поткрепени со соодветни финансиски средства. Приоритет е и обезбедување на електронски систем за спроведување на постапките поврзани со данокот на имот, нешто за што ЗЕЛС се залага веќе пет години, но досега не добила поддршка ниту од централната власт, ниту од меѓународните организации присутни во земјава. Во тој процес, потребно е и Агенцијата за катастар на недвижности да ни ги префрли бесплатно податоците на имателите на имот. Воведувањето на ваков електронски систем ќе значи: обезбедување правичност во примена на даночната политика кон сите даночни обврзници подеднакво; обезбедување дополнителни континуирани приходи за општината; поедноставување на процедурите поврзани со плаќање, но и со неплаќање на овој данок, транспарентност на постапките и друго", истакна претседателот на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски, кој на организаторите им посака успешна реализација на овој традиционален настан.

**Изнесени заложбите за поддршка на локалната самоуправа за понатамошен развој**

Во присуство на градоначалници, советници, општинска администрација, претставници од централната власт, претставници од домашни и странски организации, воведно обраќање имаа и министерот за локална самоуправа, Ристо Пенов; амбасадорката на Швајцарија во нашата земја, Вероник Улман; амбасадорката на Шведска, Ами Ларсон Џаин и Армен Григорјан, постојан претставник на УНДП.

„И покрај отежнатите околности, поврзани со енергетската криза која го окупира буџетот, може да изразам задоволство од иницијативноста на општините за изнаоѓање начини за справување со состојбите. И Извештајот на УНДП за задоволството на граѓаните од општинските услугите, не покажува драстични отстапувања од претходните години, освен во делот на изразено сомневање за корупција, каде оваа година 24 % од населението изразило ваков сомнеж, а во 2017 година изнесувал 5 %". Ова го нагласи министерот за локална самоуправа Ристо Пенов, кој посочи дека ова е патоказ каде што треба да се преземат соодветни активности за подобрување. Тој говореше и за овогодишниот скрининг

komunës dhe këshillave, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të decentralizimit, pra transferimin e përgjegjësive të reja ndaj komunave, por të mbështetura nga burimet e duhura financiare. Prioritet është sigurimi i një sistemi elektronik për zbatimin e procedurave që lidhen me tatimin e pronës. Diçka për të cilën BNJVL avokon që pesë vite, por deri më tani nuk ka marrë mbështetje as nga pushteti qendror e as nga organizatat ndërkombëtare të pranishme në vend. Është e nevojshme që Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive të n'a transferojë falas të dhënat e pronarëve të pronave. Vendosja e një sistemi të tillë elektronik do të nënkuptojë: sigurimin e drejtësisë në zbatimin e politikës tatimore ndaj të gjithë tatimpaguesve në mënyrë të barabartë; sigurimi i të hyrave shtesë të vazhdueshme për komunën; thjeshtësimi i procedurave lidhur me pagesën por edhe mospagesën e këtij tatimi; transparencë e procedurave dhe më shumë", tha kryetari i BNJVL-së, Orce Gjorgjievski, i cili organizatorëve u uroi realizim të suksesshëm të këtij manifestimi tradicional.

**U prezantuan zotimet për përkrahjen e vetëqeverisjes lokale për zhvillim të mëtejmë**

Në prezencën e kryetarëve të komunave, këshilltarëve, administratës komunale, përfaqësuesit e pushtetit qendror, nga organizatat në vend dhe organizatat e huaja, fjalim patën edhe ministri për vetëqeverisje lokale, Risto Penov; ambasadorja e Zvicrës në vendin tonë, Veronik Ullman; ambasadorja e Suedisë, Ami Larson Xhain dhe Armen Grigorijan, përfaqësues i përhershëm i UNDP-së.

"Përkundër rrethanave të vështira, që lidhen me krizën energjetike, e cila okupon buxhetet, mund të shpreh kënaqësinë për iniciativën e komunave për të gjetur mënyra për të përballuar situatën. Njëkohësisht, edhe Raporti i UNDP-së për kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet komunale nuk tregon devijime drastike nga vitet e kaluara, përveç pjesës të dyshimit të shprehur për korrupsion, ku këtë vit 24% e popullsisë kanë shprehur dyshime të tilla, ndërsa në vitin 2017 ka qenë 5%". Këtë e theksoi ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Risto Penov, i cili theksoi se ky është një udhërrëfyes ku duhet të ndërmerren veprime të duhura për përmirësim. Ai foli edhe për skriningun e sivjetshëm të Komisionit Evropian, ku theksohet nevoja



на Европската комисија, каде се нагласува потребата за подобрување на јавните услуги, што кореспондира со мислењата на граѓаните, а ја нагласи и важноста на партнерство со ЗЕЛС за подобрување на системот на локалната самоуправа, при што говореше и за поддршката на општините за изработка на техничка документација за поголеми инфраструктурни проекти, за финансирањето на проекти за планските региони и за кофинансирањето на активностите од ИПА 2 програмата на ЕУ.

Амбасадорката на Швајцарија, Вероник Улман, нагласи дека децентрализацијата значи гаранција за поквалитетен живот на граѓаните и инклузивна слика во земјата, а Програмата за развој на Швајцарија со години го поддржува овој процес и локалната власт во повеќе сегменти, особено во областа на транспарентното работење. Таа посочи дека од бројните посети што ги имала во општините можела да забележи дека онаму каде што се чувствува поголема волја и ентузијазам се постигнуваат повисоки резултати, независно што кај сите општини е евидентен недостатокот на финансиски средства. Таа ја најави поддршката за спроведување на новата програма за зголемување на општинската отпорност на корупција.

За поддршката на локалната власт во нашата земја, говореше и амбасадорката на Шведска, Ами Ларсон Цаин, која посочи дека нејзината земја има цел да ѝ помогне на Северна Македонија на патот за членство во Европската Унија, при што како посебни области ги посочи заштитата на животната средина и значењето на стратегискиот пристап при спроведувањето на сите активности, преку изработка на соодветна планска документација.

„Локалниот развој е важна компонента во поширокиот развој на земјата“, истакна постојаниот претставник на УНДП во нашата земја, Армен Григорјан. Тој говореше за досегашните активности на оваа организација во поддршката за јакнење на дијалогот на регионален развој, вклучувањето на граѓаните во демократското одлучување, во процесите на дигитализација, транспарентноста, јакнењето на капацитетите на општинските совети, изработката на техничка документација за проекти и друго, при што го најави новиот оглас за аплицирање на нови општини, од кои 10 ќе добијат поддршка во рамките на програмата за локален развој и децентрализацијата.

për përmirësimin e shërbimeve publike, që përputhet me mendimet e qytetarëve, si dhe theksoi rëndësinë e partneritetit me BNJVL-në për përmirësimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale, ndërsa foli edhe për mbështetjen e komunave lidhur me përgatitjen e dokumentacionit teknik për projekte më të mëdha infrastrukturore, për financimin e projekteve për rajonet planifikuese dhe për bashkëfinancimin në pjesën e aktiviteteve të programit IPA 2 të BE-së.

Ambasadorja e Zvicrës Veronik Ullman theksoi se decentralizimi do të thotë garanci për cilësi më të mirë të jetës për qytetarët dhe imazh gjithëpërfshirës në vend dhe Programi Zvicëran për Zhvillim ka vite që e mbështet këtë proces dhe pushtetin lokal në disa segmente. sidomos në pjesën e funksionimit transparent. Ajo theksoi se nga vizitat e shumta që ka pasur nëpër komuna, ka vërejtur se aty ku ka më shumë vullnet dhe entuziazëm, arrihen rezultate më të larta, pavarësisht se mungesa e mjeteve financiare është evidente në të gjitha komunat. Ajo paralajmëroi mbështetjen për zbatimin e programit të ri për rritjen e rezistencës komunale ndaj korrupsionit.

Lidhur me mbështetjen e pushtetit lokal në vendin tonë foli edhe ambasadorja e Suedisë, Ami Larson Xhain, e cila theksoi se vendi i saj synon t’a ndihmojë Maqedoninë e Veriut në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, me ç’rast si lëmenj veçantë vuri në dukje mjedisin jetësor dhe rëndësinë e qasjes strategjike gjatë zbatimit të të gjitha aktiviteteve, nëpërmjet përpilimit të dokumentacionit të duhur planifikues.

“Zhvillimi lokal është një komponent i rëndësishëm në zhvillimin më të gjerë të vendit”, theksoi përfaqësuesi i përhershëm i UNDP-së në vendin tonë, Armen Grigorjan. Ai vuri në dukje aktivitetet e deritanishme në fushën e mbështetjes për përforcimin e dialogut për zhvillimin rajonal, përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje demokratike, në proceset e dixhitalizimit, transparencës, përforcimit të kapaciteteve të këshillave komunale, përgatitjes së dokumentacionit teknik për projekte dhe të tjera, me ç’rast paralajmëroi shpalljen e re për aplikimin e komunave të reja, 10 prej të cilave do të marrin mbështetje në kuadër të programit për zhvillim lokal dhe decentralizim.








### Можност за отворен и инклузивен дијалог за натамошни чекори за развој на демократските процеси во земјата

Примарната цел на конференцијата е да се воспостави платформа за отворен и инклузивен дијалог за критичните предизвици и можности за локален развој фокусиран на граѓаните. Се создаваат можности за размена на искуства меѓу општините, креаторите на политики од земјава и од регионот, домашни и меѓународни организации. На конференцијата се дебатираше за потенцијалните решенија и пристапи што треба да овозможат ефикасно и успешно реализирање на основните принципи од Програмата за одржлив локален развој и децентрализација 2021 – 2026. Клучните теми опфатени на овој настан беа: системот на локална самоуправа, локална демократија, финансирање на локалните самоуправи, креирање политики засновани на докази, меѓуопштинска соработка, градење капацитети на локално ниво, родово одговорни општини, развој на општините во контекст на ЕУ перспективата на земјата, дигитализација на локалните самоуправи, мобилизирање ресурси за локални проекти, како и други релевантни прашања. За предизвиците со кои се соочуваат, но и за добрата практика што ја спроведуваат, говореа градоначалниците на: Валандово, Велес, Крива Паланка, Радовиш, Желино и на Град Скопје, потоа советниците од Гостивар и од Град Скопје, како и претставници од општинската администрација.

### Mundësi për dialog të hapur inkluziv lidhur me hapat e mëtejmë për zhvillimin e proceseve demokratike në vend

Qëllimi kryesor i konferencës është krijimi i një platforme për dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës mbi sfidat kritike dhe mundësitë për zhvillimin lokal të fokusuar ndaj qytetarëve. Krijohen mundësi për shkëmbimin e përvojave ndërmjet komunave, politikëbërësve nga vendi dhe rajoni, organizatave vendase dhe ndërkombëtare. Në konferencë u debatua për zgjidhjet dhe qasjet e mundshme që duhet të mundësojnë zbatimin efikas dhe të suksesshëm të parimeve bazë të Programit për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal dhe Decentralizim 2021-2026. Temat kryesore të trajtuara në këtë ngjarje ishin: sistemi i vetëqeverisjes lokale, demokracia lokale, financimi i vetëqeverisjes lokale, hartimi i politikave të bazuara në fakte, bashkëpunimi ndërkomunal, ngritja e kapaciteteve në nivel lokal, komunat reaguese ndaj gjinive, zhvillimi komunal në kuadrin e perspektivës së vendit të BE-së, dixhitalizimi i pushteteve lokale, mobilizimi i burimeve për projektet lokale, si dhe çështje të tjera relevante. Lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohen, por edhe për praktikat e mira të cilat i zbatojnë diskutuan kryetarët e komunave: Vallandovë, Veles, Kriva Pallankë, Radovish, Zhelinë dhe të Qytetit të Shkupit, pastaj këshilltarët nga Gostivari dhe nga Qyteti i Shkupit, si dhe përfaqësuesit e administratës komunale.

## ПРАКТИЧНИ ИСКУСТВА ОД ВИЕНА И ЛИНЦ ЗА ПОТЕНЦИЈАЛОТ НА ДИГИТАЛИЗАЦИЈАТА НА ЛОКАЛНО НИВО

Создавањето „паметни градови“ преку дигитална транзиција на локалната власт е една од приоритетните заложби на Европската Унија. Сè поголема е поддршката што таа им ја дава на земјите од Западен Балкан, особено на локалните самоуправи и на општинската администрација за преземање посериозни чекори во дигитализацијата на услугите во речиси сите области што се под локална надлежност, но и во инфраструктурата на сајбер безбедноста и отворените податоци.

Поттикнувањето на општините да го осознаат трансформативниот потенцијал на дигитализацијата на локално ниво, не се спроведува само преку финансиска и експертска поддршка, туку и преку меѓурегионална соработка и заемно учење на едни од други општини и градови, од веќе реализираните иновативни дигитални примери од практиката. Во таа насока, на 5 и 6 декември 2023 година, членовите на работната група за дигитализација на Мрежата на асоцијации на локални власти во Југоисточна Европа (НАЛАС), каде има и претставник од ЗЕЛС, беа на студиска посета во Австрија, во градовите Линц и Виена. Посетата беше организирана во рамките на проектот BACID III, финансиран од Австриската агенција за развој (АДА), а се имплементира преку НАЛАС и Центарот за истражување на јавната администрација (КДЗ).

Во рамките на посетата на Линц, работната група беше во лабораторијата за иновации на Градот Линц

## PËRVOJA PRAKTIKE NGA VJENA DHE LINZ LIDHUR ME POTENCIALIN E DIGJITALIZIMIT NË NIVEL LOKAL

Krijimi i “qyteteve të mençura” përmes tranzicionit të pushtetit lokal është një ndër angazhimet prioritare të Bashkimit Evropian. Gjithnjë e më e madhe është përkrahja që ajo u’a jep vendeve nga Ballkani Perëndimor, veçanërisht të vetëqeverisjeve lokale dhe të digjitalizimit të shërbimeve në pothuajse të gjithë lëmenjtë që është në kompetencë lokale, por edhe në pjesën e infrastrukturës dhe të sigurisë kibernetike dhe të dhënave të hapura.

Nxitja e komunave të identifikojnë potencialin transformues të digjitalizimit në nivel lokal, nuk zbatohet vetëm përmes përkrahjes financiare dhe të ekspertëve, por edhe përmes bashkëpunimit ndër-rajonal dhe mësimit të ndërsjellë të disa komunave në komunat dhe qytetet tjera, nga tashmë praktikat e realizuara inovative digjitale. Në këtë drejtim, më 5 dhe 6 dhjetor, 2023 anëtarët e grupit punues për digjitalizim të Rrjetit të asociacioneve të pushteteve lokale në Evropën Juglindore (NALAS), ku ka përfaqësues nga BNJVL, pastaj ishin edhe në vizitë studimore në Austri, në qytetet Linz dhe Vjenë. Vizita u organizua në kuadër të projektit BACID III, të financuar nga Agjencia austriake për zhvillim (ADA) ndërsa implementohet përmes NALAS dhe Qendrës për hulumtim të administratës publike KDZ.

Në kuadër të vizitës së Linz, grupi punues ishte në laboratorin për inovacione të Qytetit Linz (Innovationshauptplatz der Stadt Linz) u informua me

(Innovationshauptplatz der Stadt Linz) и се запозна со иновативните проекти за учество на граѓаните, како и со значењето на отворените податоци и дигитализацијата на Линц. Од посетата на Арс електроника - центар на креативност и врвна технологија, посебни импресии оставија новите сознанија од светот на вештачката интелигенција, а посебен интерес предизвика и работилницата за вештачка интелигенција.

Соочувајќи се со намален наталитет и пензионерски бран во следните 10 години, Виена интензивно внимание посветува и на важноста од надградување на работната сила и проверка на компетентноста, што е особено важно за јавниот сектор. Дел од насоките водат кон воведување на активности за замена на работната сила преку пазарот на трудот, но и преку усовршување во комбинација со проекти за дигитализација кои ги поддржуваат луѓето во нивната секојдневна работа.

**Иновативните дигитални технологии и новите социоекономски пристапи сѐ поприсутни во урбанизацијата на Виена**

Новите технологии и иновативните процеси, исто така, помагаат домовите, зградите и градовите да бидат поефикасни, прогресивни и еколошки. Градот Виена води посебна грижа за социјалното домување и со инвеститорите склучува договори, каде што дел од станбената површина минува во нејзина сопственост, која потоа им ја изнајмува на одредена категорија граѓани со поповолни услови. Сето тоа е имплементирано во еден од најамбициозните европски проекти за урбан развој, „Seestadt Aspern" во Виена. Изградбата на нов урбанистички округ во Виена за 20 000 жители, кој треба во целост да биде завршен до 2030 година, не е посебен само по големината туку, пред сѐ по иновативниот пристап за заштеда на ресурси и современиот урбан развој поддржан со иновативни дигитални технологии и развивање на нови општествени услови за живот. Во таа насока е и урбаната стратегија на Виена, што содржи низа решенија за паметен климатски град со многу дигитални проекти, од кои дел се веќе реализирани. Градот неодамна воведе и најсовремен систем на издавање дозвола на градба, каде пред издавањето на градежната дозвола, новиот предлог-објект се споредува директно во просторот, во планот на градот Виена изготвен во 3Д-технологија.

projektet inovative për pjesëmarrjen të qytetarëve, si dhe me rëndësinë e të dhënave të hapura dhe digjitalizimit të Linz. Nga vizita e Ars Elektronika – qendër e kreativitetit dhe teknologjisë së lartë mbresa të veçanta lanë njohuritë e reja nga bota e inteligjencës artificiale dhe punëtoria e inteligjencës artificiale shkaktoi interes të veçantë.

Duke u përballur me rënije të nivelit të natalitetit dhe një valë pensionistësh në 10 vitet e ardhshme, qyteti i Vjenës po i kushton gjithashtu vëmendje të madhe rëndësisë së përmirësimit të fuqisë punëtore dhe kontrollit të kompetencës, e cila është veçanërisht e rëndësishme për sektorin publik. Disa nga drejtimet çojnë në futjen e aktiviteteve të zëvendësimit të fuqisë punëtore përmes tregut të punës, por edhe përmes përmirësimit të aftësive në kombinim me projektet e dixhitalizimit që mbështesin njerëzit në punën e tyre të përditshme.

**Teknologjitë inovative digjitale dhe qasjet e reja socio-ekonomike janë më të pranishme në urbanizimin e Vjenës**

Teknologjitë e reja dhe proceset inovative ndihmojnë gjithashtu për t'i bërë shtëpitë, ndërtesat dhe qytetet më efikase, progresive dhe miqësore me mjedisin. Qyteti i Vjenës kujdeset në mënyrë të veçantë për banesat sociale dhe lidh marrëveshje me investitorët, ku një pjesë e zonës së banimit bëhet pronë e tij, të cilën më pas u'a jep me qira një kategorie të caktuar qytetarësh me kushte më të favorshme. E tërë kjo, implementohet në njërin prej projekteve evropiane më ambicioze për zhvillim urban "Seestadt Aspern" në Vjenë. Ndërtimi i qarkut të ri urbanistik në Vjenë për 20.000 banorë, që duhet në tërësi të përfundojë deri në vitin 2030 nuk është i veçantë vetëm në bazë të madhësisë, për edhe qasjes gjithnjë e më inovative për kursim të resurseve dhe zhvillimit bashkëkohor urbanistik të përkrahur me teknologjitë inovative digjitale dhe zhvillimin e kushteve të reja sociale të jetës. Në këtë drejtim është edhe strategjia urbanistike e qytetit të Vjenës, që përmban një sërë zgjidhjes për qytet të zgjuar klimatik me shumë projekte digjitale, prej të cilave një pjesë tashmë janë realizuar. Qyteti para do kohë themeloi edhe sistem më modern të dhënies së lejes për ndërtim, ku para dhënies së lejes për ndërtim, propozim-objekti i ri zbatohet drejtpërdrejtë në hapësirat, në planin e Qytetit të Vjenës të përpiluar me teknologji 3D.





## ПОРАДИ НЕДОСТАТОК НА КООРДИНИРАНИ РЕШЕНИЈА, ИЗОСТАНУВААТ ПОТРЕБНИТЕ ЕФЕКТИ ОД ПОДДРШКАТА ВО ДИГИТАЛИЗАЦИЈАТА НА ЛОКАЛНО НИВО

„Дигитализација на локално ниво" беше темата на првиот состанок за координирање на политики меѓу надлежните институции и донаторската заедница. Процесот на координација го водат Министерството за локална самоуправа и Амбасадата на Швајцарија во соработка со Секретаријатот за европски прашања и Делегацијата на Европската Унија, а целта е координативно дејствување за подобро спроведување на активностите за дигитализација и дигитална трансформација во општините.

Пред присутните се обрати извршната директорка на ЗЕЛС, Душица Перишиќ, која нагласи дека ЗЕЛС има повеќе од десетгодишно искуство во поддршката на општините за обезбедување на електронски услуги за граѓаните. Таа посочи дека сите општини активно ги користат трите електронски системи: дозвола за градба; градежно земјиште и продажба на движни и недвижни ствари за чија примена добиваат секојдневна поддршка од ЗЕЛС. „Воведовме и електронски систем за издавање на Б – интегрирани еколошки дозволи, но не заживеа доволно бидејќи беше дадена и можност за примена на хартиената форма. Затоа сметаме дека не треба да се дозволува парцијална можност за употреба на дигиталните системи и дека треба да се воведуваат што повеќе електронски услуги за граѓаните. И покрај тоа што слушаме за интензивните заложби за дигитализација, ЗЕЛС веќе пет години наназад бара поддршка за воведување на електронски систем за даноци на имот, но досега не доби позитивен одговор ниту од државата ниту од меѓународната заедница. Се надеваме дека граѓаните наскоро ќе може да ја спроведуваат оваа обврска по електронски пат", рече Перишиќ и потсети дека ЗЕЛС е секогаш подготвена за конструктивен дијалог кој оди во насока за обезбедување на поквалитетни услуги за граѓаните; поголема ефикасност на општинската администрација; помалку трошоци во постапките и обезбедување транспарентно работење и превенција од коруптивни дејства.

### Електронскиот систем за данок на имот меѓу приоритетите во дигитализацијата на општините, најави министерот за локална самоуправа

Претставниците од УНДП, од Делегацијата на ЕУ и од УСАИД на состанокот ги презентираа проектите преку кои се спроведуваат активности за дигитализација на локалните услуги, а за поддршката на единиците на локалната самоуправа што ја дава Швајцарија, говореше амбасадорката на оваа земја,

## PËRSHKAK TË MUNGESËS SË ZGJIDHJEVE TË KOORDINUARA, MUNGOJNË EFEKTET E NEVOJSHME TË MBËSHTETJES SË DIGJITALIZIMIT NË NIVEL LOKAL

"Digjitalizimi në nivel lokal" ishte temë e mbledhjes së parë për koordinim të politikave midis institucioneve kompetente dhe bashkësisë së donatorëve. Procesin e koordinimit e udhëheqin Ministria për vetëqeverisje lokale dhe Ambasada e Zvicrës në bashkëpunim me Sekretariatin për çështje evropiane dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian, ndërsa qëllimi është veprim i koordinuar për zbatim më të mirë të aktiviteteve për digjitalizim dhe transformim digjital në komunat.

Para të pranishmëve u drejtua drejtori ekzekutiv i BNJVL-së, Dushica Perishiq, që përmendi se BNJVL ka përvojë më të gjatë se dhjetë vjet në përkrahjen e komunave për sigurimin e shërbimeve elektronike për qytetarët. Ajo përmendi se të gjitha komunat në mënyrë aktive i shfrytëzojnë të tria sistemet elektronike: leja për ndërtim, toka ndërtimore dhe shitja e sendeve të tundshme dhe të patundshme, për zbatimin e të cilave marrin përkrahje çdo ditë nga BNJVL.

– Kemi themeluar sistem elektronik për dhënien e lejeve B-integruese ekologjike, por nuk arriti "të mbijetojë" pasi u dha mundësi për zbatim opsional në formë të shkruar. Për këtë arsye ne besojmë se nuk duhet lejuar mundësia e pjesshme e përdorimit të sistemeve digjitale dhe të futen sa më shumë shërbime elektronike për qytetarët. Përkundër faktit se dëgjojmë për përpjekje intensive për digjitalizim, BNJVL ka pesë vjet që kërkon mbështetje për krijimin e sistemit elektronik për tatimin në pronë, por deri më tani nuk ka marrë përgjigje pozitive as nga shteti, as nga bashkësia ndërkombëtare. Shpresojmë se qytetarët së shpejti do të mund t'a zbatojnë këtë obligim në mënyrë elektronike - theksoi Perishiq dhe përkujtoi se BNJVL është gjithmonë e gatshme për dialog konstruktiv që shkon në drejtim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për qytetarët; efikasitet më i madh i administratës komunale; më pak kosto në procedura dhe sigurimin e funksionimit transparent dhe parandalimin e veprimeve korruptive.

### Sistemi elektronik për tatim të pronës, midis prioriteteve në digjitalizim të komunave, paralajmëroi ministri për vetëqeverisje lokale

Në takim përfaqësues të UNDP-së, Delegacionit të BE-së dhe USAID-it prezantuan projektet përmes së cilave realizohen aktivitetet për digjitalizimin e shërbimeve lokale, ndërsa ambasadorja e këtij vendi, Veronik Hulman diskutoi për mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes lokale nga Zvicra.

Вероник Хулман. Претставниците од централната власт од нашата земја посочија дека спроведувањето на дигитализацијата е една од приоритетните задачи со цел достигнување на просекот на земјите од ЕУ во однос на развојот на дигиталното општество и економија. Министерот за локална самоуправа, Ристо Пенов, посочи дека за реализација на овие цели се потребни многу финансиски средства и дека во последните неколку години, со поддршката во оваа област од разни организации, не се постигнати потребните ефекти, заради што е потребна заемна координација и синхронизиран стратегиски пристап. Беше нагласено дека првенствено внимание ќе биде посветено на воведувањето електронски систем за постапките околу наплатата на данокот на имот. Министерот за информатичко општество и администрација (МИОА), Азир Алиу, најави дека во фаза на усвојување од Владата на РСМ значајни се стратегиските документи како: Националната стратегија за сајбер безбедност, како и Националната ИКТ стратегија 2023 – 2027 која се базира на 4 основни столба кои ги вклучуваат дигиталната поврзаност и ИКТ инфраструктурата, развивање на дигиталните вештини кај граѓаните, развој на дигитална влада, како и засилена поддршка за дигитализација на бизниси, ИКТ овозможувачи и поттикнување на дигитални иновации. И заменикот на претседателот на Владата задолжен за политики за добро владеење, Славица Грковска, потврди дека некоординираните активности по разни институции не дадоа ефекти за граѓаните, затоа приоритет е подготовката на законски решенија кои ќе бидат база на натамошната имплементација, како и ажурирање на листа на проекти од сите донации. Исто така, Грковска посочи и на потребата од структурно реорганизирање на општините и во дигитализацијата на процесите, особено за обезбедување на оптимален дигитален менаџмент систем.

Përfaqësuesit e pushtetit qendror nga vendi jonë treguan se zbatimi i dixhitalizimit është një nga obligimet prioritare për të arritur mesataren e vendeve të BE-së në drejtim të zhvillimit të një shoqërie dhe ekonomie dixhitale. Ministri për vetëqeverisje lokale, Risto Penov, theksoi se realizimi i këtyre qëllimeve kërkon shumë mjete financiare dhe se në vitet e fundit me mbështetjen në këtë fushë nga organizata të ndryshme nuk janë arritur efektet e nevojshme, për ç'arsye nevojitet një koordinim i ndërsjellë dhe një qasje e sinkronizuar strategjike. U theksua se vëmendja kryesore do t'i kushtohet themelimit të një sistemi elektronik për procedurat e arkëtimit të tatimit në pronë. Ministri për shoqëri informatike dhe administratë (MSHIA), Azir Aliu, paralajmëroi se në fazë të miratimit nga Qeveria e RMV janë dokumentet e rëndësishme strategjike siç janë: Strategjia nacionale për siguri kibernetike si dhe Strategjia nacionale për TIK 2023-2027 që bazohet në 4 shtylla kryesore, të cilat përfshijnë lidhshmëri digjitale dhe infrastrukturë TIK, zhvillimi i aftësive digjitale te qytetarët, zhvillimi i Qeverisë digjitale, si dhe përkrahja e përforcuar për bizneset digjitale, mundësuesit e TIK dhe nxitja e inovacioneve digjitale. Edhe zëvendësi i Kryetarit të Qeverisë, të obliguar për politika dhe qeverisje të mirë, Sllavica Gërkovska, përcaktoi se aktivitetet e pa koordinuara në bazë të institucioneve të ndryshme nuk dhanë efekte për qytetarët, prandaj prioritet janë përgatitja e zgjidhjeve ligjore që do të jenë bazë e implementimit të mëtejmë, si dhe azhurnimi i listës së projekteve nga të gjitha donacionet. Ajo theksoi edhe nevojën për riorganizim strukturor të komunave, ku mes tjerash edhe optimizimi i proceseve të cilat pastaj do të digjitalizohen, në sistem të menaxhmentit digjital.

## НАДЗОРНИОТ ОДБОР НА ЗЕЛС ДИСКУТИРАШЕ ПО ПРЕДЛОГ-БУЏЕТОТ НА ЗЕЛС ЗА 2024 ГОДИНА

Надзорниот одбор на ЗЕЛС одржа седница на 4 декември 2023 година, непосредно пред одржувањето на петтата седница на Генералното собрание на ЗЕЛС. Присутните ги разгледаа Предлог-буџетот на ЗЕЛС за 2024 година и Предлог-акцискиот план на ЗЕЛС за 2024 и дадоа „зелено светло“ за нивно презентирање, дискусија и усвојување од делегатите на седницата на Генералното собрание.

### Активностите предвидени во Акцискиот план за 2024 година ја следат реализацијата на стратегиските цели на ЗЕЛС

Активностите во Акцискиот план за 2024 година ги следат стратегиските цели на ЗЕЛС. Лобирањето пред централната власт за реформи во системот на локалната самоуправа, обезбедување на финансиска стабилност и соодветни промени во законската регулатива за соодветно спроведување на префрлените надлежности, претставуваат најважната стратегиска цел што се реализира преку активностите на телата на ЗЕЛС. Тука е вклучено и континуираното информирање на општините, како важен дел од активностите на ЗЕЛС. Речиси секојдневно ЗЕЛС испраќа информации до општините преку електронска пошта и поставува на веб-страницата, а исто така подготвува и месечно Гласило на ЗЕЛС што бесплатно се дистрибуира до сите општински советници и други лица. Информациите се однесуваат на сите

## BORDI MBIKËQYRËS I BNJVL-SË DISKUTOI MBI PROPOZIM-BUXHETIN E BNJVL-SË PËR VITIN 2024

Bordi mbikëqyrës i BNJVL-së mbajti seancë më 4 dhjetor, 2023, drejtpërdrejtë para mbajtjes së seancës së pestë të Kuvendit Gjeneral të BNJVL-së. Të pranishmit i shqyrtuan Buxhetin e BNJVL-së për vitin 2024 dhe Propozim – Planin aksional të BNJVL-së për vitin 2024 dhe shfaqën “dritë të gjelbër” për prezantimin e tyre, diskutimi dhe miratimi nga delegatët në seancën e Kuvendit Gjeneral.

### Aktivitetet e parashikuara në Planin aksional për vitin 2024 ndjekin realizimin e qëllimeve strategjike të BNJVL-së

Aktivitetet në Planin aksional për vitin 2024 ndjekin qëllimet strategjike të BNJVL-së. Lobimi para pushtetit qendror për reformat në sistemin e vetëqeverisjes lokale, sigurimi i stabilitetit financiar dhe ndryshimet adekuate rregullativën ligjore për zbatimin e duhur të kompetencave të bartura, paraqesin qëllimin më të rëndësishëm strategjik që realizohet përmes aktiviteteve të organeve të BNJVL-së. Këtu përfshihet edhe informimi i vazhdueshëm i komunave, si pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të BNJVL-së. Pothuajse çdo ditë, BNJVL u dërgon informacione komunave përmes postës elektronike dhe i ngarkon në ueb faqen, si dhe përgatit një buletin mujor të BNJVL-së që u shpërndahet pa pagesë të gjithë këshilltarëve komunalë dhe personave të tjerë. Informacioni ka

настани, активности, проекти, иницијативи за промени на закони и други подзаконски акти поврзани со локалната власт и спроведувањето на општинските надлежности.

